

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8361
E mërkurë, 12 gusht 2026
Çmimi 0. 50 €

Ahmeti: U ndjeva goxha keq kur e pashë Kurtin krah Mickoskit | F. 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

RAMA I PËRGJIGJET BEOGRADIT PËR IBRIN: KOSOVA ËSHTË REPUBLIKË SOVRANE

 | F. 4-5

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, i është përgjigjur ashpër Beogradit lidhur me debatin për ndryshimin e rrjedhës së lumit Ibër, duke theksuar se Kosova është republikë

sovrane dhe se burimet natyrore brenda territorit të saj nuk i përkasin Serbisë. Rama ka kundërshtuar edhe përpjekjet e Beogradit për ta zhvendosur debatin te

"Shqipëria e Madhe", duke argumentuar se çështja e ujërave ndërkufitare duhet të trajtohet mbi bazën e së drejtës ndërkombëtare dhe jo përmes "folklorit politik"

E ZHYTUR NË KRIZË INSTITUCIONALE, KOSOVA RREZIKON HUMBJEN E PËRHERSHME TË MILIONAVE NGA BE-ja | F. 7



PDK-ja: DO TA MBROJMË RENDIN KUSHTETUES ME ÇDO MJET | F. 5



OPINION

SOARIME KUSHTETUESE MBI KRIZËN AKTUALE DHE BLOKIMIN E KONSTITUIMIT TË INSTITUCIONEVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS | F. 8-9

Shkruan:
Akademik Arsim
BAJRAMI



AKTUALE



THAÇI MBETET NË PARABURGIM DERI NË AKTGJYKIM, SPECIALJA NUK KËRKON MË PARASHTRESA PËR RISHIKIMIN E RADHËS | F. 3

HAXHIU DEKORON SENATOREN ERNST ME MEDALJEN PRESIDENCIALE TË MERITAVE | F. 5

EKONOMI



SHIQK-u PADIT MUJËN DHE AVUK-un: DËMET NDAJ QUMËSHTOREVE DHE FERMERËVE JANË TË MËDHA | F. 8

SPORT

FFK-JA MBAN TAKIM ME DELEGATËT PARA EDICIONIT TË RI: MOBILIZIM MAKSIMAL PËR NJË KAMPIONAT TË SUKSESSHËM | F. 10

RENOVA
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
PUTZ
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 870
044 500 878 | 049 500 870

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

BASHAR AL-ASSADI DËNOHET ME VDEKJE, NË MUNGESË

DAMASK, 11 GUSHT - Një gjykatë siriane ka dënuar me vdekje në mungesë ish-presidentin Bashar al-Assad pasi e ka shpallur fajtor për “krime lufte” dhe “krime kundër njerëzimit” të kryera gjatë luftës civile në Siri. Me vdekje është dënuar edhe kushëriri i tij, Atef Najib, i cili akuzohet për udhëheqjen e shtypjes së protestave në provincën e Daraas në vitin 2011, ngjarje që shënuan fillimin e kryengritjes dhe përshkallëzimin e konfliktit të armatosur në vend.

Nën masa të rrepta sigurie, Najib ishte i pranishëm në sallën e gjyqit, i veshur me uniformën e të burgosurit, ndërsa gjyqtari lexoi vendimin. Bashar al-Assad dhe vëllai i tij, Maher, janë larguar drejt Rusisë pasi kryengritësit kanë marrë kontrollin e Damaskut në dhjetor të vitit 2024. Ndërkohë, Najib është arrestuar më vonë dhe është bërë një nga figurat më të larta të ish-regjimit që është përballur me drejtësinë. Najib, ish-gjeneral brigade i




ushtrisë siriane, në vitin 2011 drejtonte Degën e Sigurisë Politike në provincën Dara, ku forcat e regjimit shtypën protestat që më pas u shndërruan në një kryengritje mbarëkombëtare.

Vendimi ndaj Assadit përbën dënimin e parë me vdekje të një figure të lartë të ish-regjimit nga autoritetet kalimtare siriane, të cilat këtë vit kanë nisur procese gjyqësore ndaj zyrtarëve të ish-qeverisë, si në praninë e tyre, ashtu edhe në mungesë.

ZELENSKY: RUSIA PO PËRDOR RAKETA TË KORESË SË VERIUT PËR TA SULMUAR UKRAINËN

KIEV, 11 GUSHT - Ukraina dhe Rusia kanë vazhduar sulmet ndaj njëra-tjetrës, ku Volodymyr Zelensky ka akuzuar Moskën për përdorimin e raketave të Koresë së Veriut. Presidenti ukrainas ka thënë se sulmet në Zaporizhzhia, të cilat kanë vrarë të paktën gjashtë persona dhe kanë plagosur të paktën 19 të tjerë, kanë përfshirë raketa balistike nga aleati i Rusisë. Në Voronezh,

në jug të Rusisë, depot që i përkisnin shitësit me pakicë online, Wildberries, janë goditur nga Ukraina. Kompania, e njohur si Amazon i Rusisë, është shënjestruar vazhdimisht në javët e fundit. Sulmet kanë ardhur një ditë pasi të paktën 13 persona janë vrarë, përfshirë një fëmijë, në sulmet me dronë ukrainas në republikën ruse të Tatarstanit,



më shumë se 1,100 kilometra (680 milje) nga kufiri ukrainas. Në një video-adresim, Zelensky ka thënë “për herë të parë” se

Rusia “nuk mund të zhvillojë luftë pa përf forcime nga Koreja e Veriut”. “Sa më shumë sulme të Koresë së Veriut të ketë këtu në Ukrainë, në Evropë, aq më shumë përdoren raketat dhe ushtarët e tyre, aq më shumë ata korrigjojnë mangësitë dhe pikat e tyre të verbra”, ka thënë Zelensky, duke shtuar se kjo përbën një rrezik për pjesën tjetër të botës. Në fjalimin e tij,

Zelensky ka përshëndetur gjithashtu një sulm ajror të suksesshëm në një uzinë petrokimike ruse në Siberinë perëndimore të hënën, duke e cilësuar atë si një “arritje shumë të rëndësishme” nga ushtria ukrainase. Ai ka premtuar “më shumë sulme të thella ukrainase të cilat duhet t’i tregojnë Rusisë dhe rusëve se paqja është e nevojshme”.

MBI 160 TË VDEKUR NGA NJË TËRMET I FUQISHËM NË KOLUMBI

CARACAS, 11 GUSHT - Mbi 160 persona kanë humbur jetën pasi një tërmet i fuqishëm ka goditur Kolumbinë perëndimore të hënën, duke shembur ndërtesa në disa qytete dhe duke lënduar qindra të tjerë, ndërsa ende shumë banorë mbeten të bllokuar nën rrënoja. Tërmeti ka goditur vetëm disa ditë pasi Abelardo De La Espriella është betuar si president, duke e futur administratën e re në krizën e saj të parë madhore, dhe pak javë pasi dy tërmete shkatërruese kanë goditur vendin fqinj, Venezuelën.

“Qeveria kombëtare i ka vënë në dispozicion të gjitha kapacitetet e saj për t’i mbrojtur jetët, për t’i ndihmuar komunitetet e prekura

dhe për të ofruar ndihmë kudo që nevojitet”, ka thënë ai në një fjalim pasi ka shpallur gjendjen e jashtëzakonshme në nivel kombëtar.

Tërmeti me magnitudë 7.4, sipas Shërbimit Gjeologjik të ShBA-së, ka goditur në një thellësi prej 107 kilometrash pranë San Jose del Palmarit, në Choco, një provincë në bregdetin e Paqësorit të Kolumbisë, por është ndjerë në qytetet e mëdha në mbarë vendin.

Numri më i lartë i raportuar i viktimave ka qenë në provincën perëndimore të Risaraldës, në rajonin e Kolumbisë ku kultivohet kafeja, ku guvernatori Juan Diego Patino, duke folur në telefon për televizionin



“Caracol”, ka raportuar 42 viktima. Tërmetet më të vogla nuk janë të pazakonta në Kolumbi, e cila përshkohet nga tri vargmale të Andeve. Megjithatë, janë rrëshqitjet e tokës ato që historikisht kanë qenë

fatkeqësitë natyrore më vdekjeprurëse në vend, ku katastrofa e Armeros në vitin 1985 ka vrarë rreth 25 000 persona. Qytetet në rajonin e kafesë në vend, përfshirë Armeninë dhe Pereiran, janë goditur nga një tërmet

shkatërrues me magnitudë 6.2 në vitin 1999, i cili ka vrarë më shumë se 1 000 persona.

Autoriteti i Aviacionit Civil të Kolumbisë ka deklaruar se fluturimet janë pezulluar në aeroportet e Pereiras, Manizalesit, Quibdós, Armeninës, Cartagos dhe Buenaventuras, ndërsa inspektorët kanë kontrolluar për dëme strukturore. Sistemi i paralajmërimit për cunami i ShBA-së ka deklaruar se nuk ka pasur kërcënim për cunami pas tërmetit. Venezuela është goditur nga dy tërmete shkatërruese në qershor, të cilat kanë vrarë më shumë se 6 000 persona, kryesisht në bregdetin pranë kryeqytetit, Caracas.

Trumpi kufizon vaksinat për fëmijët

UASHINGTON, 11 GUSHT - Presidenti amerikan, Donald Trump, ka nënshkruar një urdhër ekzekutiv që parashikon më pak vaksinime për fëmijët, duke e kufizuar përdorimin e tyre në vetëm 11 lloje virusesh dhe sëmundjesh. Urdhri gjithashtu rekomandon ndarjen e vaksinës së fruthit, shtyave dhe rubeolës për fëmijët në tri doza dhe dhënien e dozave në

vizita të ndara mjekësore. Ekspertët e kanë kundërshtuar këtë vendim të presidentit amerikan. Agjencia e lajmeve “Reuters” ka cituar ekspertët, të cilët kanë thënë se zvogëlimi i vaksinave të rekomanduara do t’i lërë më shumë fëmijë të prekshëm ndaj sëmundjeve të parandalueshme.

Sipas presidentit Trump, ulja e numrit të vaksinave dhe ndarja e dozave është më

efektive. “Me efekt të menjëhershëm, administrata ime po njej rekomandimet e vaksinave të fëmijërisë në 11 vaksinime kryesore kundër sëmundjeve më serioze dhe të rrezikshme. Vaksina e fruthit, shtyave dhe rubeolës po ndahet në tri doza të veçanta të vetme dhe vaksinat do të bëhen në vizita të veçanta. Për shembull, në një vit duhet të bëhen vizita të veçanta për

vaksinat në vend që t’i bëhen të gjitha në të njëjtën ditë”, ka thënë Trumpi.

Urdhri udhëzon prokurorin e përgjithshëm të ngrejë padi mbi ligjet shtetërore që bien ndesh me këtë urdhër federal të presidentit. Urdhri i ri është nënshkruar para se nxënësit të kthehen në shkolla në Shtetet e Bashkuara dhe pasi vendi është përballur me një shtim të rasteve të fruthit. Të dhënat



federale tregojnë se normat e vaksinimit në kopshte në Shtetet e Bashkuara kanë rënë, sidomos gjatë vitit të fundit shkollor.

Ahmeti: U ndjeva goxha keq kur e pashë Kurtin krah Mickoskit

SHKUP, 11 GUSHT - Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, ka folur për raportet me kryeministrin në detyrë të Kosovës, Albin Kurti, duke treguar edhe për një çast që, sipas tij, e ka bërë të ndihet keq emocionalisht. Ahmeti është pyetur për qëndrimin e tij ndaj Kurtit dhe ndikimin e tij në Maqedoninë e Veriut.

Ahmeti ka thënë se e ka prekur veçanërisht fakti që Kurti ishte parë krah kryeministrit të Maqedonisë së Veriut, Hristijan Mickoski, në një kohë kur, sipas tij, Mickoski kishte deklaruar se shqipja nuk kishte qenë asnjëherë gjuhë zyrtare.

“Nuk kam argumente, por më ka bërë goxha të ndihem keq kur e kam parë krah Mickoskit, kur tha se gjuha shqipe s’ka qenë kurrë zyrtare. Më solli në kujtesë nënën e Afrim Kalanicës”, ka thënë Ahmeti në “Click” të “RTV21”.

Ai ka rrëfyer edhe një moment emocional që lidhet me familjen e dëshmorit Afrim Kalanica. “Kur e pashë që lotët i ranë te varri i Afrim Kalanicës, i cili ka qenë një oficer i jashtëzakonshëm... Për çfarë u vra Afrim Kalanica, Fadil Nimani? Janë dëshmorë që kanë luftuar këtu, kanë mundur të vriten këtu”, ka thënë Ahmeti.

Më tutje, Ahmeti ka komentuar bashkëqeverisjen e VLEN-it me VMRO-në. Ai ka thënë se VLEN-i

është pushtet pa pushtet në Maqedoninë e Veriut. “S’po pyet kurrkush, çfarë mbrojtën, mos dolën ta mbrojnë gjuhën, mos dolën ta mbrojnë përfaqësimin e drejtë, çfarë avancimin, dolën te korridori e thanë është ngjarje historike... Unë nuk jam nihilist, një punë të vogël me bërë, të kishin avancuar, nuk përtoj se është në të mirë të shqiptarëve, por nuk e kanë bërë. Nuk kanë bërë ndonjë punë që të themi e bënë diçka, përkundrazi e kanë denigruar, e kanë poshtëruar shqiptarin, e kanë kthyer mbrapa situatën, si në iniciativën për Ligjin e Gjuhës, për përfaqësimin e drejtë, për çështjen e Tribunalit të Hagës”, ka thënë ai, duke shtuar se



ballafaqimin politik e ka me VMRO-në dhe jo me VLEN-in. “Për VLEN-in kam keqardhje, përse për një karriqe denigruan,

poshtëruan legjitimitetin e shqiptarëve, sepse në Maqedoni votohet në baza etnike”, ka thënë Ahmeti.

THAÇI MBETET NË PARABURGIM DERI NË AKTGJYKIM, SPECIALJA NUK KËRKON MË PARASHTRESA PËR RISHIKIMIN E RADHËS

HAGË, 11 GUSHT - Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, do të vazhdojë të qëndrojë në paraburgim deri në shpalljen e aktgjykimit në rastin e përbashkët ndaj tij, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Trupi gjyqësor i Gjykatës Speciale në Hagë ka refuzuar kërkesën për lirimin e Thaçit dhe ka vendosur vazhdimin e paraburgimit të tij. Ky është vendimi i 27 për vazhdimin e masës së paraburgimit ndaj ish-presidentit.

Në vendimin e datës 10 gusht, trupi gjyqësor ka vlerësuar se aktualisht nuk ka informacion të mjaftueshëm për të konstatuar se Thaçi do t’i shmangej drejtësisë në rast se do të lirohej. Megjithatë, gjyqtarët kanë konstatuar se vazhdon të ekzistojë një rrezik i mjaftueshëm që ai të mund ta pengojë përparimin e procedurave të Dhomave të Specializuara apo të ndikojë te dëshmitarët. “Paneli përfundon se, në këtë kohë, vazhdon të ketë informacion të pamjaftueshëm para tij që justifikon një



konstatim se z. Thaçi mund t’i shmangej drejtësisë nëse lirohet. Megjithatë, Paneli është i kënaqur, bazuar në standardin përkatës, se ekziston një rrezik i mjaftueshëm që z. Thaçi do të

pengojë përparimin e procedurave të Dhomave të Specializuara dhe se ai do të kryejë krime të mëtejshme kundër atyre që perceptohen si kundërshtarë të UÇK-së,

përfshirë dëshmitarët që kanë dhënë prova në këtë çështje”, është thënë në vendim. Aktgjykimi në rastin ndaj Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit pritet të shpallet më 16 shtator

2026. Në të njëjtin vendim, kryegjyqtari Charles Smith ka urdhëruar që palët të mos paraqesin më parashtrësia lidhur me rishikimin e ardhshëm të paraburgimit të Thaçit, i cili sipas afateve do të duhej të zhvillohej më 9 tetor 2026.

Sipas trupit gjyqësor, ky shqyrtim nuk është më i nevojshëm për momentin, pasi seanca për shpalljen e aktgjykimit është caktuar për 16 shtator. “Paneli vëren se, në përputhje me nenin 41(10), shqyrtimi i ardhshëm i paraburgimit të z. Thaçi, në parim, është i caktuar të bëhet të premten, më 9 tetor 2026, përveç nëse aktgjykimi i gjykimit shpallet ndërkohë”, është thënë në vendimin e Gjykatës Speciale.

Gjykimi ndaj Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit është duke u zhvilluar në Hagë që nga viti 2023. Prokuroria është duke i akuzuar ata për një sërë veprash penale që pretendohet se janë kryer gjatë dhe pas luftës në Kosovë, ndërsa të gjithë të akuzuarit janë deklaruar të pafajshëm.

Haxhiu dekoron senatoren Ernst me Medaljen Presidenciale të Meritave

PRISHTINË, 11 GUSHT - Ushtruesja e detyrës së presidentes së Kosovës, Albulena Haxhiu, ka pritur në takim senatoren amerikane me Medaljen Presidenciale të Meritave, për kontributin në fuqizimin e partneritetit Kosovë-ShBA dhe mbështetjen e zhvillimit të kapaciteteve mbrojtëse të Kosovës. “Me senatoren Ernst ka diskutuar për zhvillimet aktuale politike në Kosovë, çështjet e sigurisë dhe rëndësinë e vazhdimin të bashkëpunimit të ngushtë me Amerikën. Në shenjë

mirënjohjeje për angazhimin senatores Ernst ndër vite, Haxhiu ka dekoruar senatoren amerikane me Medaljen Presidenciale të Meritave, për kontributin në fuqizimin e partneritetit Kosovë-ShBA dhe mbështetjen e zhvillimit të kapaciteteve mbrojtëse të Kosovës. “Me senatoren Ernst diskutova për zhvillimet aktuale politike në Kosovë, për çështjet e sigurisë dhe për rëndësinë e vazhdimin të bashkëpunimit të ngushtë me Shtetet e Bashkuara. Në shenjë



mirënjohjeje për angazhimin e saj ndër vite, e dekorova senatoren Ernst me Medaljen Presidenciale të Meritave, për kontributin e çmuar në fuqizimin e partneritetit Kosovë-ShBA dhe në mbështetjen e zhvillimit të kapaciteteve mbrojtëse të Republikës së Kosovës. Kosova do të vazhdojë ta ndërtojë të ardhmen e saj krah Shteteve të Bashkuara, duke forcuar një partneritet që për vendin tonë ka rëndësi të veçantë strategjike dhe historike”, ka njoftuar Haxhiu.

RAMA I PËRGJIGJET BEOGRADIT PËR IBRIN: KOSOVA ËSHTË REPUBLIKË SOVRANE

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, i është përgjigjur ashpër Beogradit lidhur me debatin për ndryshimin e rrjedhës së lumit Ibër, duke theksuar se Kosova është republikë sovraane dhe se burimet natyrore brenda territorit të saj nuk i përkasin Serbisë. Rama ka kundërshtuar edhe përpjekjet e Beogradit për ta zhvendosur debatin te “Shqipëria e Madhe”, duke argumentuar se çështja e ujërave ndërkufitare duhet të trajtohet mbi bazën e së drejtës ndërkombëtare dhe jo përmes “folklorit politik”

EPOKA E RE

Lirim GECI

TIRANË, 11 GUSHT - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka ndërhur në debatin në mes të Tiranës dhe Beogradit lidhur me deklaratën e presidentit serb Aleksandër Vuçiq për mundësinë e ndryshimit të rrjedhës së lumit Ibër. Ky lumë që buron në Mal të Zi kalon përmes Serbisë dhe më pas në Kosovë. Rama ka thënë se çështja ka të bëjë me ujërat ndërkufitare dhe parimet e së drejtës ndërkombëtare. “Serbia është plotësisht e lirë t’i menaxhojë burimet brenda juridiksionit të saj. Ajo që nuk mund të argumentojë në mënyrë të arsyeshme është se pasojat e mundshme për një vend tjetër ndalen në mënyrë magjike në kufirin serb. Në fund të fundit, kjo është arsyeja pse ekziston ligji ndërkombëtar i ujit”, ka shkruar Rama në platformën “X”.

Sipas kryeministrit shqiptar, pavarësisht prej debatit politik dhe historik rreth tij, lumi Ibër do të vazhdojë të ndjekë gjeografinë. Rama u është përgjigjur deklaratave të mëhershme të ministrit të Jashtëm të Serbisë, Marko Gjuriq, ndaj homologut të tij shqiptar, Ferit Hoxha, i cili e ka akuzuar Shqipërinë për “ndërhurje të motivuar politikisht”.

Rama e ka cilësuar zhvendosjen e debatit nga çështja e ujërave ndërkufitare te “Shqipëria e Madhe” dhe statusi i Kosovës si pjesë të një “folklori politik” në Beograd duke theksuar se Shqipëria nuk ka pretendime territoriale ndaj Serbisë. “Sa herë që Shqipëria flet për Kosovën, ‘Shqipëria e Madhe’ duhet të thirret menjëherë, sikur përsëritja një ditë mund ta shndërronjë një fantazmë të vjetër në një argument të rëndësishëm”, ka shkruar Rama. Sipas tij, Shqipërisë nuk i nevojitet një projekt i “Shqipërisë së Madhe” për ta mbështetur Kosovën duke shtuar se “territori i Kosovës nuk është territor serb dhe se burimet natyrore që ndodhen brenda tij nuk janë burime të Serbisë”.

“Kosova është një shtet më vete. Shqiptarët e Kosovës janë pikërisht kjo: shqiptarë të Kosovës. Ata kanë Republikën e tyre, institucionet e tyre dhe të drejtën për të përcaktuar të ardhmen e tyre. Ne do të qëndrojmë gjithmonë në mbështetje të kësaj të drejte. Serbia e humbi Kosovën. Përsëritja se nuk e ka humbur mund ta shndërronjë ndoshta humbjen në fitore në gjeografinë e imagjinatës politike, por fatkeqësisht hartat janë më pak tolerante. Territori i Republikës së Kosovës nuk është territor serb dhe burimet natyrore që ndodhen brenda tij nuk janë burime të Republikës së Serbisë. Miq të tanë serbë e dinë shumë mirë këtë, përfshirë edhe kur ulemi së bashku në tryezat



evropiane”, ka shkruar Rama. Ndaj kësaj, Gjuriqi ka reaguar sërish, duke e cilësuar debatin për lumin Ibër si shmangie nga ajo që ai pretendon se është çështja kryesore, rrënim i shtëpive të serbëve pranë liqenit të Ujmanit nga autoritetet e Kosovës. “Qeveria e Albin Kurtit po e shfrytëzon këtë verë për të rrënuar shtëpi serbe, pa proces të rregullt ligjor, përgjatë brigjeve të Liqenit të Gazivodës (Ujmanit) dhe Ibrit, duke ua mohuar njerëzve pronën, qasjen dhe mjetet e jetesës përmes veprimeve që janë haptazi diskriminuese në baza etnike”, ka shkruar Gjuriqi në “X”.

Gjuriqi ka kundërshtuar gjithashtu përfshirjen e Shqipërisë në këtë debat, duke argumentuar se “Ibri është një rrjedhë ujore ndërkufitare... por ai nuk hyn kurrë në Shqipëri dhe nuk është pjesë e sistemit lumor të Shqipërisë”.

Si rifilloi debati për lumin Ibër?

Më 9 gusht, presidenti serb Aleksandër Vuçiq përsëriti qëndrimin e tij - të disa viteve më parë - për mundësinë e ndryshimit të kahut të Ibrit, duke thënë se tashmë kanë nisur konsultimet me ekspertë të fushës. Deklaratat e tij janë kundërshtuar nga ushtruesja e detyrës së presidentes së Kosovës, Albulena Haxhiu, e cila e ka cilësuar idenë “absurde”, “kërcënuese” dhe “shoviniste”. “Serbia vazhdon politikën e saj hegjemoniste ndaj Kosovës. Një tjetër shqetësim serioz që duhet të adresohet me partnerët tanë ndërkombëtarë janë edhe deklaratat e fundit të Vuçiqit për mundësinë e ndryshimit të rrjedhës së lumit Ibër. Siç e dini, Ibër-Lepenci dhe

liqeni i Ujmanit janë pjesë e një sistemi esencial për furnizim me ujë, për energjinë, bujqësinë dhe jetën e qindra mijëra qytetarëve të Kosovës. Ndërhurja e njëanshme në rrjedhat ujore ndërkufitare do të kishte pasojat shumë përtej një çështjeje teknike. Ajo do të prekte sigurinë ujore, energjetike, mjedisore dhe njerëzore të Republikës sonë”, është shprehur Haxhiu. Edhe ministri shqiptar për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ferit Hoxha, ka reaguar duke thënë se ndryshimi i rrjedhës së një lumi, që është pjesë e një sistemi ujor ndërkufitar, nuk mund të trajtohet si çështje e brendshme e një shteti dhe as të vendoset vetë në mënyrë të njëanshme. Ndaj tij ka reaguar Gjuriqi, i cili ka akuzuar duke thënë se Serbia, si shtet sovran, do të vendosë vetë për mënyrën e menaxhimit të burimeve të saj natyrore.

Hoxha i reagon Gjuriqit: Lumenjtë duhet të bartin ujë, jo kërcënime

Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme i Shqipërisë, Ferit Hoxha, i ka reaguar përsëri ministrit të Jashtëm të Serbisë, Marko Gjuriq, duke theksuar rëndësinë e dialogut, besimit dhe bashkëpunimit pragmatik në rajon. Hoxha ka vlerësuar tonin në të qetë të mesazhit të Gjuriqit, por ka thënë se e ardhmja e rajonit nuk duhet të ndërtohet mbi kërcënime dhe akuza. “E vlerësoj sentimentin më të qetë në përmbjlljen e mesazhit të Marko Gjuriqit, sepse pikërisht aty qëndron e ardhmja e rajonit tonë: jo të kërcënimit dhe akuzat, por të dialogu, besimi dhe bashkëpunimi pragmatik”,

ka shkruar Hoxha në rrjetet sociale.

Duke iu referuar debatit për lumin Ibër dhe burimet ujore, Hoxha ka theksuar se uji nuk njeh kufij politikë. “Uji është jetë. Ai nuk mban pasaportë, nuk lexon hartat politike dhe nuk ndalet të pyesë se në cilën anë të kufirit po rrjedh”, ka deklaruar ai. Sipas Hoxhës, përdorimi i ujit si mjet ndëshkimi nuk mund të konsiderohet vetëm si çështje e një shteti tjetër. “Po, Ibri nuk rrjedh përmes Shqipërisë. Por nëse nesër dikush do të kërcënonte ta ndërpriste Serbinë nga uji që rrjedh përmes territorit të tyre, Shqipëria do të ishte po aq e zëshme”, ka shkruar Hoxha.

Ai ka shtuar se një reagim i tillë nuk do të lidhej me faktin nëse ai ujë përfundon apo jo në Shqipëri, por me parimin e bashkëjetesës paqësore në rajon. “Ky është roli i fqinjëve, apo jo? Të mos llogarisim nëse uji arrin fillimisht te rubineti ynë para se të vendosim nëse duhet të na interesojë, por të kujdesemi para se llogaritje të tilla të përcaktojnë lagjen ku jetojmë”, ka thënë ai.

Hoxha ka bërë thirrje që debati të largohet nga retorika nacionaliste dhe të fokusohet te bashkëpunimi rajonal. “Lumenjtë duhet të bartin ujë, jo kërcënime, ndërsa kufijtë duhet të përcaktojnë juridiksionet, jo të ndajnë përgjegjësinë tonë për paqen”, është shprehur ministri shqiptar.

Hoxha ka përmendur edhe diskutimet për konceptet “e Madhe” që, sipas tij, janë rikthyer në debat, duke thënë se Shqipëria është e interesuar vetëm për një “Bashkim Evropian më të Madh”. “Sa iu përket të gjitha gjërave ‘të Mëdha’ të thirrura në këtë diskutim, Shqipëria mbetet e interesuar

vetëm për një: një Bashkim Evropian më të Madh, që përfshin Kosovën, Serbinë, Shqipërinë dhe pjesën tjetër të rajonit tonë”, ka shkruar ai.

Hoxha ka thënë se Shqipëria është e gatshme të punojë për shembuj konkretë të bashkëpunimit mes shqiptarëve dhe serbëve. “Le të vazhdojmë me më shumë Evropë, më pak mitologji dhe më shumë arsye për ta parë të kaluarën tonë përmes syve të së ardhmes, në vend që ta shohim të ardhmen përmes syve të së kaluarës. Dhe, po, ujë për të gjithë. Për të pirë në paqe dhe për të ujitur, po aq paqësisht, tokat pjellore të lagjes sonë të përbashkët dhe të bukur”, ka përfunduar Hoxha.

Lumi Ibër, rreth 270 kilometra i gjatë, buron në Mal të Zi, kalon nëpër Serbi dhe më pas në Kosovë, ku furnizon liqenin artificial të Ujmanit. Rreth dy të tretat e liqenit ndodhen në territorin e Kosovës.

Sistemi Ibër-Lepenc furnizon me ujë disa komuna të Kosovës, përdoret për ujtitje dhe për ftohjen e termocentraleve në Obiliq.

Serbia është palë e Konventës së Kombeve të Bashkuara të vitit 1997 për përdorimin jonavigacional të rrjedhave ujore ndërkombëtare.

Ideja për ndryshimin e rrjedhës së Ibrit nuk është e re. Në dhjetor të vitit 2024, pas shpërthimit që kishte dëmtuar kanalën e Ibër-Lepencit në Zubin Potok, Vuçiqi pati deklaruar se një ide e tillë ekziston që prej vitit 1985 dhe se në atë kohë ai vetë ka qenë kundër saj.

BE-ja: Deklaratat e Serbisë për ndryshimin e rrjedhës së Ibrit nuk ndihmojnë normalizimin e raporteve

Bashkimi Evropian (BE) ka paralajmëruar se deklaratat e zyrtarëve serbë për mundësinë e ndryshimit të rrjedhës së lumit Ibër nuk kontribuojnë në normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Zëdhënësja e BE-së, Anita Hipper, ka thënë në një konferencë për medie se çështjet e hapura ndërmjet dy palëve mund të zgjidhen vetëm përmes dialogut. “Gjithashtu rikujtojmë se përparimi në dialogun ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës është parakusht që të dyja palët të avancojnë në rrugën e tyre evropiane”, ka thënë Hipper.

KUSARI-LILA: S'KA ALTERNATIVË TJETËR POS DIALOGUT POLITIK

PRISHTINË, 11 GUSHT - Ministria në detyrë e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, njëherësh kryetare e Alternativës, Mimoza Kusari-Lila, ka deklaruar se moskonstituimi i Kuvendit të Kosovës po shkakton shqetësim te qytetarët, mërgimtarët dhe komuniteti i biznesit.

Kusari-Lila ka thënë se situata aktuale paraqet shqetësim të madh edhe për sigurinë e investimeve në Kosovë. "Moskonstituimi i Kuvendit është brengë për mërgimtarët, është brengë për qytetarët e Republikës, është brengë shumë e madhe për bizneset për sigurinë e investimeve në Kosovë", ka deklaruar ajo. Sipas saj, në situatën aktuale nuk ka alternativë tjetër përveç dialogut politik dhe arritjes së një marrëveshjeje ndërmjet subjekteve politike.

Ajo u ka bërë thirrje drejtuesve politikë dhe partiakë që të ulen në tryezën e dialogut dhe të merren vesh për një plan konkret institucional. "Megjithatë, nuk ka alternativë tjetër pos dialogut politik, arritjes së marrëveshjes politike dhe pranimit të drejtuesve

politikë e partiakë të Republikës së Kosovës se veç të ulen, të dakordohen dhe të kemi një orar e afat edhe të konstituimit të Kuvendit, të votimit të Qeverisë dhe të zgjedhjes së presidentit. Singlerisht, ju them të drejtën, është një keqardhje që komunikimi i drejtuesve politikë, në veçanti të opozitës së deritanishme, po bëhet përmes medieve e jo përmes pranimit të pjesëmarrjes në takim. Unë e kuptoj rëndësinë e deklaratave politike, e kuptoj rëndësinë e komunikimit me elektoratin e secilit se, fatmirësisht, jemi në demokraci. Secili ka votuesit e përkrahësit e orientimeve të veta politike, por interesi i shtetit është një. Kosova ka nevojë për Kuvend të konstituuar, për qeveri të votuar, për president ose presidente që është në zyrë me mandat të plotë", ka thënë Kusari-Lila, duke shtuar se kjo situatë nuk i shkon për shtati askujt, por gjithashtu edhe prej kësaj situatë nuk mund të dilet e të ketë zgjidhje pa dialog politik. "Është me të vërtetë e pakuptimtë mosmarrëveshja ose mospranimi i ftesës për të qenë në takim me kryetarin e Lëvizjes Vetëvendosje,



kryeministrin në detyrë, zotin Albin Kurti. Nuk ka arsytim. Nuk mundet asnjë argument i cili, qoftë me vendimin mos me qenë në qeveri ose me qenë në opozitë, apo me vendimin se nuk po ka besim të ndërsjellë. Gjysma e elektoratit të qytetarëve me të drejtë vote ia kanë dhënë besimin grupit të

Lëvizjes Vetëvendosje bashkë me partnerët e vet. Prandaj, edhe si e tillë, nuk mundet askush të mendojë për një formim të institucioneve, konstituim të organeve drejtuese të shtetit, pa Lëvizjen Vetëvendosje. Prandaj, edhe mospranimi në diskutim të mëturjeshëm, qoftë i Partisë

Demokratike apo i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, nuk ka arsytueshmëri", ka thënë Kusari-Lila.

Ajo ka thënë se mospranimi i takimeve për konstituimin e institucioneve paraqet më shumë shkelje të besimit demokratik sesa çështje të formës së realizimit të tyre.

PDK-ja: DO TA MBROJTMË RENDIN KUSHTETUES ME ÇDO MJET

PRISHTINË, 11 GUSHT - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka reaguar lidhur me situatën politike në vend, duke argumentuar se po shkelen afatet kushtetuese dhe rregullat për zhvillimin e seancës konstituive të Kuvendit.

PDK-ja ka paraqitur tri pika që, sipas saj, sqarojnë situatën rreth konstituimit të Kuvendit. Në një reagim në "Facebook", PDK-ja i është referuar nenit 66 të Kushtetutës, duke theksuar se Kuvendi duhet të zgjidhet me mandat katërvjeçar dhe se seanca konstituive duhet të mbahet brenda 30 ditësh nga dita e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve. "Për ta sqaruar thjesht për qytetarët se çfarë po ndodh me Kuvendin: 1. Kushtetuta përcakton se Kuvendi duhet të konstituohet brenda 30 ditësh nga certifikimi i rezultateve të zgjedhjeve. 2. Gjykata Kushtetuese e ka bërë edhe më të qartë: 30 ditët nuk



janë vetëm afat për ta nisur procesin. Brenda këtij afati

Kuvendi duhet të konstituohet. 3. Rregullorja e Kuvendit

përcakton se, derisa të përfundojë seanca konstituive

me zgjedhjen e kryetarit dhe nënkryetarëve, ndërprerjet nuk mund të zgjasin më shumë se 48 orë", është thënë në reagimin e PDK-së.

PDK-ja ka përmendur edhe Aktgjykimin KO124/25 të Gjykatës Kushtetuese, duke theksuar se, sipas interpretimit të Gjykatës, afati 30-ditor nuk është vetëm afat për fillimin e procedurës, por brenda këtij afati duhet të konstituohet Kuvendi. "Afati 30-ditor ka kaluar pa u konstituuar Kuvendi. Tash po shpërfilllet edhe rregulli 48-orësh. Kushtetuta nuk është rekomandim. Aktgjykimet nuk janë opsionale. Rregullat vlejnë për të gjithë edhe për pushtetin. Ajo që po ndodh është suspendim dhe goditje e drejtpërdrejtë ndaj rendit kushtetues të Republikës. PDK-ja do ta mbrojtë rendin kushtetues me çdo mjet!", është thënë në reagimin e PDK-së.

"Seancë kur të ketë marrëveshje", Dehari: S'ka kuptim të vazhdojmë pa rezultate

Prishtinë, 11 gusht - Kryesuesi Avni Dehari ka folur për seancën konstituive të Kuvendit. Në një deklaram për medie, Dehari ka thënë se seanca do të thirret vetëm pasi të arrihet një marrëveshje mes partive politike. "Sanca do të

thirret kur të ketë marrëveshje", ka deklaruar Dehari. Ai ka theksuar se vazhdimi i seancave pa një pajtim politik nuk do të sillte zgjidhje për situatën e krijuar në Kuvend. "Me rregullore, por nuk ka sanksione për këtë. Më mirë

është të kemi marrëveshje, që të zgjidhet problemi. Ne e dimë se më 28 dhjetor u mbajtën 57 seanca dhe nuk sollën asgjë të re. Çfarë kuptimi do të kishte të mbaheshin seancat vazhdimisht, nëse nuk kemi rezultate?", ka thënë Dehari.



IKShPK-ja bën thirrje për kujdes nga malaria: Mbrohuni nga pickimet e mushkonjave!

PRISHTINË, 11 GUSHT - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë thirrje për kujdes ndaj malaries, veçanërisht për qytetarët që udhëtojnë në zona ku ekziston rreziku nga kjo

sëmundje.

IKShPK-ja u ka bërë thirrje qytetarëve që të informohen paraprakisht për rrezikun para udhëtimit dhe të marrin masa për t'u mbrojtur nga pickimet e mushkonjave.

Instituti ka këshilluar që personat që kanë qëndruar në zona me rrezik për malaria të kërkojnë menjëherë ndihmë mjekësore nëse pas kthimit shfaqin simptoma si temperaturë, dhimbje koke,

lodhje dhe dobësi, të përziera apo vjellje. IKShPK-ja ka theksuar rëndësinë e informimit, parandalimit dhe reagimit me kohë për një shëndet më të sigurt.



KËRKOHET PARABURGIM NDAJ TRE PERSONAVE LIDHUR ME RASTIN E VRASJES NË TENTATIVË DHE PJESËMARRJES NË RRAHJE NË GJAKOVË

GJAKOVË, 11 GUSHT - Prokuroria Themelore në Gjakovë njofton opinionin publik lidhur me rastin e ndodhur dje, më 10 gusht 2026 në Gjakovë, ku disa persona janë përfshirë në një rrahje si pasojë e një mosmarrëveshjeje, ndërsa një person është plagosur me armë zjarri. Prokurori i Shtetit ka autorizuar Policinë e Kosovës për ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të nevojshme lidhur me këtë rast. Me vendim të Prokurorit të Shtetit janë ndaluar tre (3) persona të dyshuar me inicialet H. D., A. D. dhe E. G., në kohëzgjatje prej dyzet e tetë (48) orësh, si dhe një (1) i mitur është

ndaluar në kohëzgjatje prej njëzet e katër (24) orësh. Lidhur me këtë rast është marrë aktvendim për fillimin e hetimeve dhe është parashtruar kërkesë në Gjykatën Themelore në Gjakovë për caktimin e masës së paraburgimit ndaj tre (3) të pandehurve me inicialet H. D., A. D. dhe E. G.. Ndaj të pandehurit me inicialet H. D., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprat penale "Vrasja në tentativë" nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, dhe "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve" nga neni 366 par. 1 i KPRK-së, ndërsa ndaj të pandehurve me inicialet A. D.

dhe E. G. për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale "Pjesëmarrja në rrahje" nga neni 187, par. 2 i KPRK-së. Ndërsa ndaj të miturit, i cili gjendet në ndalim prej 24 orësh, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale "Pjesëmarrja në rrahje" nga neni 187, par. 2 i KPRK-së, rasti do të trajtohet në procedurë të rregullt. Prokuroria Themelore në Gjakovë, në bashkëpunim me autoritetet kompetente, është duke ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme procedurale dhe hetimore për ndriçimin e plotë të rrethanave të rastit dhe sigurimin e provave relevante.



GJOBA PËR KOMPANITË QË SHKELËN KUFIZIMIN PËR MJETET MBI 20 TONË, AKTIVIZOHEN NJËSITË E TRAFIKUT



PRISHTINË, 11 GUSHT - Njësitë e trafikut dhe Drejtoria e Trafikut janë aktivizuar për monitorimin e qarkullimit të automjeteve të transportit të mallrave me masë totale mbi 20 tonë pas vendimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit për kufizimin e përkohshëm të lëvizjes së tyre në autostrada. Sipas vendimit të ministrisë, mjetet mbi 20 tonë nuk lejohen

të qarkullojnë në autostrada gjatë orarit të përcaktuar nga ora 11:00 deri në 17:30 për shkak të temperaturave të larta. Gjatë zbatimit të masës ekipet e trafikut kanë monitoruar hyrjet e autostradave dhe kanë ndaluar automjetet që nuk e kanë respektuar kufizimin. Si pasojë, disa kompani janë gjobitur për mosrespektim të orarit të ndalimit. Ministria e Infrastrukturës dhe

Transportit kishte kërkuar nga operatorët ekonomikë dhe ngasësit që t'i planifikojnë lëvizjet e tyre në përputhje me orarin e përcaktuar dhe ta respektojnë masën e vendosur. Ndërkohë, kufizimi vlen vetëm për autostradat, ndërsa në rrugët nacionale, rajonale dhe lidhëse qarkullimi i automjeteve të transportit të mallrave mbi 20 tonë lejohet pa kufizime.

EKSTRADOHET NGA SHQIPËRIA NË KOSOVË NJË I DËNUAR ME 11 VJET E 6 MUAJ BURGIM PËR VRASJE



PRISHTINË, 11 GUSHT - Policia e Kosovës ka njoftuar se një shtetas i Kosovës, i kërkuar me urdhërarrest ndërkombëtar, është ekstraduar sot nga Shqipëria në Kosovë përmes pikës kufitare në Vërmicë. Policia e Kosovës, përkatësisht Drejtoria për Bashkëpunim Ndërkombëtar Policor (ILECU), në koordinim me njësitë relevante policore dhe institucionet e drejtësisë, ka realizuar ekstradimin

e të dyshuarit i cili ndodhej në arrati. Sipas policisë, personi ishte arrestuar nga autoritetet shqiptare, bazuar në një urdhërarrest ndërkombëtar të lëshuar përmes INTERPOL-it nga institucionet e drejtësisë së Kosovës. Ai ishte shpallur në kërkim për veprën penale "Vrasje", për të cilën është dënuar me 11 vjet e 6 muaj burgim. Pas përfundimit të

procedurave të ekstradimit, i dënuari iu dorëzua njësisë përkatëse të Drejtorisë Rajonale të Policisë në Pejë për procedurat e mëtejshme ligjore dhe dërgimin e tij në qendrën korrektuese për vuajtjen e dënimit. Policia e Kosovës ka vlerësuar se ky ekstradim është rezultat i bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe Shqipërisë.

Vazhdon lirimi i hapësirave publike në Mitrovicë

MITROVICË, 11 GUSHT - Komuna e Mitrovicës ka njoftuar se ka vazhduar aksionet për lirimin e hapësirave publike dhe mbrojtjen e pronës komunale. Në kuadër të

aktiviteteve të Drejtorisë së Inspeksionit janë ndërmarrë dy aksione në lokacione të ndryshme të qytetit. Në magjistralen e Adriatikut janë larguar reklamat e vendosura

në mënyrë të kundërligjshme, ndërsa në rrugën "Ahmet Selaci" është liruar prona komunale e cila ishte e uzurpuar. Drejtori i Inspeksionit, Mujë Igrishta,

ka bërë me dije se aksionet për lirimin e hapësirave publike dhe mbrojtjen e pronës komunale do të vazhdojnë edhe në ditët në vijim.



E ZHYTUR NË KRIZË INSTITUCIONALE, KOSOVA RREZIKON HUMBJEN E PËRHERSHME TË MILIONAVE NGA BE-ja



PRISHTINË, 11 GUSHT - Bashkimi Evropian (BE) ka alokuar rreth 170 milionë euro për Kosovën në kuadër të Planit të tij të Rritjes për gjysmën e dytë të vitit 2026. Por, Kosova rrezikon të humbë një shumë të konsiderueshme të këtyre mjeteve, nëse vazhdon kriza politike dhe mosfunksionimi i institucioneve shtetërore. Ajo mund t'i përfitojë mjetet financiare nga BE-ja vetëm nëse i ndërmerr reformat e domosdoshme. Më shumë se dy muaj pas zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, Kuvendi i Kosovës ende nuk është konstituuar. Seanca konstituive, e nisur më 6 gusht është shtyrë dy herë, me kërkesë të kreut të partisë fituese të zgjedhjeve, Lëvizjes Vetëvendosje.

Albin Kurti ka kërkuar kohë shtesë për konsultime me partitë e tjera lidhur për arrijtjen e një marrëveshjeje të gjerë politike, që përfshin edhe çështjen e zgjedhjes së presidentit të ardhshëm. Pikërisht mungesa e konsensusit mbi presidentin ka çuar Kosovën në zgjedhjet e parakohshme. Komisioni Evropian (KE) ka paralajmëruar se zvarritja e formimit të institucioneve të reja, pas votimeve të 7 qershorit, mund të ketë pasojë të drejtpërdrejta në zbatimin e reformave dhe në qasjen e Kosovës në fondet e BE-së.

Zëdhënësi i këtij institucioni, Guillaume Mercier, ka përsëritur thirrjen e rregullt të Brukselit drejtuar aktorëve politikë në Kosovë për të siguruar stabilitet institucional. "Është thelbësore

që institucionet e Kosovës të konstituohen pa vonesa të mëtejshme, në përputhje me kornizën kushtetuese dhe me procedurat e përcaktuara. Vonesat në formimin e institucioneve rrezikojnë t'i pengojnë reformat e rëndësishme dhe mund të ndikojnë në aftësinë e Kosovës për të përfutur plotësisht nga mundësitë e ofruara nga BE-ja, duke përfshirë edhe Planin e Rritjes për Ballkanin Perëndimor", ka thënë t Mercier për "Radion Evropa e Lirë (REL)". Në dhjetor të këtij viti skadon afati për përmbushjen e gjithsej 27 hapave reformues nga Prishtina zyrtare, me një vlerë totale prej 165.9 milionë eurosh. Shumë zyrtarë evropianë, me të cilët ka biseduar REL-i, tashmë flasin për humbje shumëmilionëshe, që Kosova mund të pësojë si pasojë e krizës institucionale.

"Ndërsa Komisioni Evropian është duke vlerësuar raportimin e Kosovës për këta hapa, situata politike në vend ka ndikuar në mënyrë të pashmangshme në ritmin e zbatimit dhe ka kufizuar përparimin në një numër reformash kyç, duke vënë në rrezik një pjesë të financimit në kuadër të Instrumentit për Reforma dhe Rritje", ka thënë për "REL"-in një zyrtar evropian, në kushte anonimiteti.

E para në hartimin e Agjendës së Reformave, e fundit në raportim

Kosova ishte ndër të parat që

dorëzoi Agjendën e Reformave në vitin 2024, por ishte e fundit që paraqiti raportin mbi nivelin e zbatimit të saj. Autoritetet e Kosovës kanë paraqitur kërkesën e parë për shpërndarjen e mjeteve, pak para skadimit të afatit, më 15 korrik 2026, duke raportuar për hapat e Agjendës së Reformave që fillimisht ishte paraparë të përmbusheshin në dhjetor 2024, qershor 2025, dhjetor 2025 dhe qershor 2026. "Për të ruajtur financimin në dispozicion, do të jetë thelbësore të sigurohet funksionimi efektiv i institucioneve dhe konsensusi politik i nevojshëm për të mbajtur fokusin e qëndrueshëm në zbatimin e agjendës së dakorduar të reformave", ka thënë një burim evropian. Zëdhënësi i KE-së, Guillaume Mercier, ka theksuar se një marrëveshje e shpejtë midis partive politike për një kandidat unifikues për president ka rëndësi të veçantë. "Vetëm një dialog efikas ndërpartiak dhe një ndjenjë e përbashkët e qëllimit do t'i lejojë Kosovës të ndjekë objektivat e përbashkëta dhe të realizojë reformat që kërkojnë qytetarët e saj", ka thënë ai për "REL"-in.

Brenda 18 muajsh Kosova kaloi nëpër tri procese zgjedhore, duke mbajtur dy herë zgjedhje parlamentare, si dhe zgjedhje lokale (dy runde). Përmbushja e hapave reformues, në kuadër të Planit të Rritjes të BE-së, kërkon angazhimin e të dy pushteteve: qeverisë, e cila harton, negocion dhe zbaton objektivat konkrete të politikave - dhe Kuvendit, i cili

miraton reformat përkatëse.

Dhjetori dhe rreziku për humbjen e përhershme të fondeve

Fundi i vitit 2026 shënon përfundimin e periudhës së tolerancës, e cila në Bruksel njihet si "periudha gri", për hapat reformues që fillimisht duhej të përmbusheshin në shtetet e rajonit, përfshirë Kosovën, në dhjetor 2024 dhe dhjetor 2025. Komisioni Evropian e mundësoi këtë periudhë tolerancë, e cila i referohet kohës pas skadimit të një afati, gjatë së cilës veprimet e vonuara mund të korrigjohen ende pa shkakuar pasojat që do të sillte mosrespektimi i afatit. Sipas këtij parimi, të gjithë hapat reformues, që kishin afatin fillestar gjatë vitit 2024, kanë afat shtesë prej 24 muajsh për zbatim. Ndërkaq, për hapat që kishin afat gjatë vitit 2025, toleranca është 12 muaj. Për të gjitha reformat e parapara për zbatim deri më dhjetor 2024, përkatësisht dhjetor 2025, afati përfundimtar është fundi i vitit 2026, kur rrezikohet humbja e përhershme e fondeve.

Nëse vendet përfituese nuk i përmbushin kushtet, përkatësisht nuk zbatojnë reformat e parashikuara, Komisioni Evropian ka të drejtë t'i mbajë fondet e destinuar për këta hapa reformues. Këto mjete mund të shpërndahen tek vendet tjera që janë më të suksesshme në procesin reformues.

Kosova, përfituesja më e madhe vetëm në teori

Pakaja e BE-së për Ballkanin Perëndimor është planifikuar për periudhën 2024-2027. Ajo ka vlerë prej 6 miliardë eurosh dhe paraqet paketën më ambicioze financiare për rajonin. Alokimi i mjeteve të Planit të Rritjes është bërë bazuar në numrin e popullsisë dhe Prodhimin e Brendshëm Bruto. Nga kjo pako, për Kosovën janë alokuar 882.6 milionë euro, çka e bën atë përfituesen më të madhe për kokë banori. Në periudhat e mëhershme, Kosova nuk u kualifikua për praninë të mjeteve nga Plan i Rritjes, meqë – gjithashtu për shkak të ngërçit politik – nuk ishin miratuar marrëveshjet relevante për këtë pako evropiane.

Pasi në shkurt të këtij viti Kuvendi i Kosovës ratifikoi marrëveshjet që lidhen me Planin e Rritjes, Kosova u kualifikua për të përfutur nga fondet evropiane. Deri më tani Kosova ka pranuar vetëm mjetet e parafinancimit në vlerë prej 61.8 milionë eurosh, që përfaqësojnë 7 për qind të shumës së përgjithshme të alokuar. Për fondet e tjera, Kosova duhet të dëshmojë zbatimin e hapave reformues, duke dorëzuar raportin për reformat e bëra. Komisioni Evropian vendos për shpërndarjen e fondeve dy herë në vit, por vetëm pasi të ketë verifikuar se një vend ka përmbushur me sukses hapat dhe objektivat konkrete të përcaktuara në Agjendën e Reformave.

Turistët e huaj në Berat, mes gastronomisë dhe shijes shqiptare

BERAT, 11 GUSHT - Pushuesit e huaj që vizitojnë qytetin e Beratit tashmë mund të shijojnë edhe një tjetër përvojë autentike shqiptare: ushqimin dhe gastronominë.

Një grup i madh turistësh të huaj në Berat kanë përjetuar një përvojë ndryshe si pjesë e kuzhinës në "Castle Park", duke gatuar receta të ndryshme shqiptare, nga hapja e petëve te përgatitja e byrekut, pastrimi dhe prerja e perimeve, ndërsa kanë shijuar verën shqiptare

mes ritmit të muzikës dhe valleve.

Kryeministri Edi Rama ka ndarë në rrjetet sociale këtë atmosferë të veçantë mes turistësh në "Castle Park" në Berat.

Berati, i njohur si "qyteti i një mbi një dritareve", vijon të zgjojë interesimin e turistëve në çdo stinë të vitit, duke u renditur ndër destinacionet më të vizituara në Shqipëri.

Rrugicat me kalldrëm të Kalasë dhe lagjet historike të

Mangalemit e Goricës mbeten pikat më të frekuentuara nga vizitorët vendas dhe të huaj të cilët tërhiqen nga trashëgimia kulturore, muzetë, kishat dhe xhamitë që mbart qyteti.

Interesim të veçantë turistët tregojnë sidomos për muzetë e qytetit, ku njihen me historinë dhe vlerat e trashëgimisë kulturore. Përveç turizmit historik, Berati tërheq gjithnjë e më shumë vizitorë edhe për turizmin natyror dhe atë të aventurës.



Zonat përreth qytetit, si fshatrat turistike me agroturizme të zhvilluara, mali i Tomorit,

ujëvara e Bogovës dhe kanionet e Osunit, janë tashmë pjesë e rëndësishme e ofertës turistike.

SHIQK-u PADIT MUJËN DHE AVUK-un: DËMET NDAJ QUMËSHTOREVE DHE FERMERËVE JANË TË MËDHA

Shoqata e Industrisë së Qumështit e Kosovës (SHIQK) ka bërë me dije se ka nisur padi ndaj ministrit në detyrë të Bujqësisë, Armend Muja, dhe Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës (AVUK), për dëmet që, sipas saj, u janë shkaktuar qumështoreve dhe fermerëve vendorë.

Kryetari i SHIQK-ut, Gani Durmishi, në një prononcim për "Kosovapress" ka thënë se sektori i industrisë së qumështit ndodhet në gjendje të rëndë. Ai i ka akuzuar institucionet përkatëse se, me vendimet dhe veprimet e ndërmarra u kanë shkaktuar dëme të mëdha prodhuesve vendorë. "Jemi në telashe të mëdha si sektor i industrisë së qumështit të Kosovës. Fushata të cilën e ka bërë Ministria e Bujqësisë dhe Tregtisë na ka bërë dëm të



jashtëzakonshëm, të nivelit të pariparueshëm, neve si industri, njëkohësisht edhe fermerëve. Ky kokë më vete i qiti disa ligje, e propozoi një

vendim dhe menjëherë na dërgoi inspektorat në fabrika. Këtu thotë 60 ditë duhet me i kontrollua që me marrë pëlqimin pastaj nga ministria.

Inspektorët e ardhur menjëherë na kanë lëshuar një procesverbal, na kanë ndërprerë prodhimin", ka thënë Durmishi.

Sipas tij, masat kanë prekur edhe eksportin dhe shitjen e produkteve të industrisë vendore të qumështit. "Të gjitha eksportet e prodhimeve të Kosovës që janë, me ndërhyrje janë ndërprerë dhe nuk janë lejuar të eksportohen. Ka dërguar edhe inspektorë në markete, që të hiqen të gjitha produktet nga raftet në markete. Kjo ka qenë shumë e papritur dhe na ka bërë dëm jashtëzakonisht të madh. Na ka dëmtuar edhe me propagandën se gjoja në Kosovë po prodhohet diçka që është kancerogjene, pa një bazë studimore, të cilën mundet me na e pru një dokument", ka thënë ai.

Durmishi ka bërë me dije se qumështoret janë duke evidencuar dhe kalkuluar dëmet e shkaktuara nga tërheqja dhe bllokimi i produkteve në treg. Ai ka thënë se një pjesë e produkteve rrezikon t'i kalojë afati i përdorimit, ndërsa ka kritikuar mungesën e komunikimit nga institucionet. Durmishi ka paralajmëruar se, nëse nuk arrihet një zgjidhje me Ministrinë e Bujqësisë dhe Ministrinë e Tregtisë, punëtorët e industrisë së qumështit dhe fermerët mund të organizojnë protesta. Sipas SHIQK-ut, procedurat ligjore synojnë ndalimin e vendimit përmes masave të përkohshme, ndërsa shoqata është duke përgatitur dokumentacionin dhe argumentet për dëmet që pretendon se u janë shkaktuar kompanive dhe fermerëve vendorë.

DOGANA DHE PROKURORIA E SHTETIT PAJTOHEN PËR FORCIMIN E LUFTËS KUNDËR KRIMIT EKONOMIK

PRISHTINË, 11 GUSHT - Drejtori i Doganës së Kosovës, Agron Llugaliu, ka zhvilluar një takim me kryeprokurorin e shtetit, Zejnulla Gashi, në të cilin është diskutuar për forcimin e bashkëpunimit ndërinstitutional në mbrojtje të interesave ekonomike dhe financiare të Kosovës.

Gjatë takimit Llugaliu e ka uruar Gashin për marrjen e detyrës së kryeprokurorit të shtetit, ndërsa ka theksuar rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet Doganës së Kosovës dhe Prokurorisë së

Shtetit për parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit ekonomik e financiar.

Në fokus të diskutimeve ka qenë koordinimi institucional për parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen e veprave penale, veçanërisht atyre që lidhen me kontrabandën, evazionin fiskal, ekonominë joformale dhe veprimtari të tjera që dëmtojnë të hyrat publike dhe konkurrencën e drejtë në treg.

Llugaliu ka vlerësuar se bashkëpunimi efektiv ndërmjet institucioneve të zbatimit të ligjit është i rëndësishëm për



rritjen e efikasitetit në luftën kundër kriminalitetit ekonomik dhe krijimin e një mjedisi më të

sigurt dhe më të drejtë për zhvillimin e aktivitetëve ekonomike. Sipas njoftimit,

gjatë takimit palët janë pajtuar për vazhdimin dhe avancimin e bashkëpunimit të ndërsjellë si dhe për ndërmarrjen e veprimeve të koordinuara, në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë ligjore të institucioneve përkatëse.

Bashkëpunimi ndërmjet Doganës së Kosovës dhe Prokurorisë së Shtetit synon rritjen e efikasitetit në parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit ekonomik, mbrojtjen e të hyrave publike dhe forcimin e mëtejshëm të sundimit të ligjit në Kosovë.

AKB-ja: Mos e përdorni qumështin si armë politike

PRISHTINË, 11 GUSHT - Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ka reaguar ndaj, siç ka vlerësuar, fushatave politike që po dëmtojnë besimin e qytetarëve te qumështi dhe produktet vendore. AKB-ja ka kërkuar që çdo produkt që nuk i plotëson

standardet të dënohet si produkt, ndërsa jo të sulmohet e gjithë industria e qumështit. "Është helmuar tregu me politikë. Qumështi vendor nuk është armë politike! Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) kundërshton fushatat politike që

po dëmtojnë besimin te qumështi dhe prodhimet vendore. Nëse ka produkt që nuk i plotëson standardet, le të dënohet ai produkt – jo të sulmohet një industri e tërë! Qumështi vendor duhet të gjykohet me analiza dhe fakte, jo

me politikë. AKB-ja kërkon kontroll të njëjtë dhe transparent për qumështin vendor dhe atë të importuar. Mos e dëmtoni fermerin dhe prodhuesin kosovar për interesa politike. Politika le të luftojë me argumente, jo me 'Made in



Kosovo", është thënë në reagimin e AKB-së.

SQARIME KUSHTETUESE MBI KRIZËN AKTUALE DHE BLOKIMIN E KONSTITUIMIT TË INSTITUCIONEVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS



Shkruan: Akademik Arsim BAJRAMI

Duke qenë njëri nga hartuesit kryesorë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, profesor i së drejtës kushtetues për 45 vite dhe duke pasur një përvojë të gjatë në procesin e ndërtimit të institucioneve të Republikës, e konsideroj të nevojshme të jap disa sqarime publike mbi situatën aktuale politike dhe kushtetuese, veçanërisht mbi bllokimin e konstituimit të Kuvendit dhe pasojat që kjo situatë mund të prodhojë për funksionimin normal të shtetit. Për një periudhë relativisht të gjatë kam zgjedhur të hesht dhe të mos jem pjesë e debatit të përditshëm politik e mediatic. Kjo heshtje nuk ka qenë mungesë interesi dhe as tërheqje nga përgjegjësia ime publike. Ka qenë një qëndrim i vetëdijshëm profesional dhe, në një masë, edhe një formë proteste ndaj degradimit të debatit kushtetues, relativizimit të ekspertizës juridike dhe shndërrimit të çështjeve serioze kushtetuese në tema të debatit të përditshëm televiziv. Kushtetuta nuk mund të interpretohet sipas logjikës së studios televizive, sipas kalkulimeve politike të ditës apo sipas interesave të momentit. Ajo duhet të lexohet në tërësinë e saj, në frymën e parimeve mbi të cilat është ndërtuar dhe në

dritën e jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese. Pikërisht për këtë arsye, në këtë moment e konsideroj detyrim profesional të flas. Po e bëj këtë jo si analist politik, por si profesor i së drejtës kushtetuese dhe si njëri nga hartuesit kryesorë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Pikëpamjet e mia po i sistemoj në dhjetë çështje themelore, të cilat, sipas vlerësimit tim, janë të rëndësishme për të kuptuar natyrën e krizës aktuale dhe për të orientuar debatin publik drejt një leximi sa më të saktë të Kushtetutës.

I. Konstituimi i Kuvendit është detyrim kushtetues, jo mundësi politike

Konstituimi i Kuvendit të Republikës së Kosovës nuk është një akt që mund të shtyhet sipas vullnetit politik të subjekteve parlamentare. Ai është një detyrim kushtetues. Neni 66.1 i Kushtetutës përcakton se seanca konstituive e Kuvendit duhet të mbahet brenda tridhjetë ditësh nga shpallja zyrtare e rezultateve të zgjedhjeve. Kjo dispozitë ka një logjikë të qartë kushtetuese: pas përfundimit të procesit zgjedhor dhe shpalljes zyrtare të rezultateve, duhet të

fillojë pa vonesë procesi i krijimit dhe funksionalizimit të institucioneve të reja. Në hartimin e kësaj dispozite, qëllimi ka qenë që afati prej tridhjetë ditësh të funksionojë si një kufi kushtetues që garanton kalimin brenda një kohe të arsyeshme nga procesi zgjedhor në funksionalizimin e Kuvendit, e jo si një periudhë të cilën subjektet politike mund ta shfrytëzojnë për ta zvarritur procesin pa kufizim. Kushtetuta është hartuar për të garantuar vazhdimësinë institucionale të shtetit dhe për të parandaluar krijimin e vakumit politik e institucional. Prandaj, konstituimi i Kuvendit nuk është çështje e vullnetit politik të një partie ose e një grupi parlamentar. Është detyrim që buron drejtëpërdrejt nga Kushtetuta. Vullneti politik është i domosdoshëm për realizimin e këtij detyrimi, por nuk mund të përdoret si arsye për ta mohuar vetë detyrimin kushtetues.

II. Afati kushtetues prej tridhjetë ditësh duhet të respektohet

Neni 66.1 përdor një formulim të qartë: seanca konstituive mbahet brenda tridhjetë ditësh nga shpallja zyrtare e rezultat-

eve të zgjedhjeve. Ky formulim nuk i jep subjekteve politike një mundësi të pakufizuar për ta shtyrë konstituimin. Afati është vendosur për të siguruar një kalim të shpejtë, të rregullt dhe kushtetues nga procesi zgjedhor në funksionalizimin e institucioneve. Kur ky afat tejkalohet pa përfunduar procesi kushtetues, atëherë kemi një çështje serioze të respektimit të Kushtetutës. Megjithatë, edhe këtu duhet të ruajmë saktësinë juridike. Një gjë është pretendimi për shkelje kushtetuese, ndërsa diçka tjetër është konstatimi përfundimtar i një shkeljeje kushtetuese. Në një shtet kushtetues, nuk mjafton që një subjekt politik ose një komentues publik të deklarojë se ka ndodhur shkelje i Kushtetutës. Çdo pretendim i tillë duhet të vlerësohet në procedurën dhe nga autoriteti kompetent. Sipas Nenit 112.1, Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës. Prandaj, nëse pretendohet se mosrespektimi i afatit kushtetues ka prodhuar një shkelje kushtetuese, çështja duhet të adresohet në mënyrë institucionale pranë Gjykatës Kushtetuese nga subjektet e autorizuar. Debatit politik nuk mund ta zëvendësojë proce-

durën kushtetuese. Kjo është një nga premiset themelore të shtetit të së drejtës: Kushtetuta interpretohet dhe zbatohet përmes institucioneve kompetente dhe jo përmes deklaratave politike.

III. Zgjedhja e kryetarit të Kuvendit është pjesë e procesit të konstituimit

Konstituimi i Kuvendit nuk duhet kuptuar si një ceremoni thjesht solemne dhe protokollare. Ai është fillimi juridik i funksionimit të institucionit parlamentar. Neni 67.1 përcakton se Kuvendi zgjedh kryetarin dhe pesë nënkryetarët nga radhët e deputetëve, ndërsa Neni 67.2 përcakton procedurën për propozimin dhe zgjedhjen e kryetarit. Kjo çështje është trajtuar edhe nga Gjykata Kushtetuese në rastin KO119/14, në të cilin është analizuar rëndësia kushtetuese e zgjedhjes së Kryetarit të Kuvendit dhe funksionalizimit të institucionit parlamentar. Kjo jurisprudencë tregon se zgjedhja e Kryetarit nuk është një çështje dytësore apo thjesht procedurale. Ajo lidhet drejtpërdrejt me funksionalizimin e Kuvendit dhe me ushtrimin e kompetencave

të tij kushtetuese. Prandaj, sub-jektet politike duhet ta përdorin vullnetin e tyre politik për ta realizuar Kushtetutën dhe jo për ta bllokuar atë. Në një demokraci parlamentare, shumicat dhe pakicat politike kanë të drejtë të konkurrojnë për postet dhe për drejtimin e institucioneve, por ky konkurrim duhet të zhvillohet brenda rregullave kushtetuese dhe parlamentare.

IV. Moskonstituimi i kuvendit nuk sjell automatikisht shpërndarjen e tij

Në debatin publik është krijuar një konfuzion serioz lidhur me pasojat juridike të moskonstituimit të Kuvendit. Është e rëndësishme të theksohet se moskonstituimi i Kuvendit brenda afatit kushtetues nuk duhet të barazohet automatikisht me shpërndarjen e tij. Neni 82 i Kushtetutës përcakton rastet në të cilat Kuvendi mund të shpërndahet. Këto raste lidhen, ndër të tjera, me dështimin e formimit të qeverisë sipas procedurës kushtetuese, me vendimin e Kuvendit për shpërndarje me shumicën e kërkuar, me moszgjedhjen e presidentit dhe me situatat e tjera të përcaktuara shprehimisht nga Kushtetuta.

Në të drejtën kushtetuese ekziston një parim themelor: kompetencat dhe shkaqet për përfundimin e parakohshëm të mandatit institucional duhet të kenë bazë të qartë kushtetuese. Kushtetuta nuk autorizon krijimin e një shkaku të ri për shpërndarjen e Kuvendit përmes një interpretimi politik. Prandaj, nuk mund të thuhet se vetëm tejkalimi i afatit për konstituim e aktivizon automatikisht mekanizmin e shpërndarjes së Kuvendit. Çdo pasojë juridike e moskonstituimit duhet të nxirret nga një interpretim sistematik i Kushtetutës dhe nga jurisprudenca përkatëse e Gjykatës Kushtetuese, e jo nga një interpretim i shkëputur ose politik i një dispozite.

V. Kemi një krizë politike dhe institucionale me pasoja kushtetuese

Në vlerësimin tim, situata aktuale duhet të emërtohet me saktësi. Kemi të bëjmë para së gjithash me një krizë politike dhe institucionale, e cila po prodhon pasoja të rëndësishme kushtetuese. Kushtetuta e Kosovës përcakton strukturën e pushtetit, kompetencat e institucioneve dhe procedurat për funksionalizimin e tyre. Por Kushtetuta nuk mund ta zëvendësojë vullnetin politik. Kur kemi hartuar Kushtetutën, nuk kemi mundur dhe as nuk ka qenë e mundur të parashikonim çdo situatë të mundshme të bllokimit politik. Një Kushtetutë nuk mund të shkruhet si një manual për çdo konflikt të mundshëm ndërmjet partive politike. Ajo është ndërtuar mbi premisën e një kulture demokratike dhe kushtetuese, në të cilën subjektet

politike respektojnë rregullat e lojës demokratike dhe, kur është e nevojshme, arrijnë kompromiset e domosdoshme për funksionimin e shtetit. Prandaj, zgjidhja e krizës aktuale është para së gjithash politike, ndërsa Kushtetuta duhet të jetë korniza detyruese brenda së cilës gjendet dhe realizohet kjo zgjidhje. Kushtetuta përcakton rregullat; politika demokratike duhet të prodhojë vullnetin për t'i zbatuar ato.

VI. Konstituimi duhet të pasohet nga formimi i qeverisë

Kushtetuta ka krijuar një zinxhir të ndërlidhur institucional: Zgjedhjet → konstituimi i Kuvendit → zgjedhja e Kryesisë → formimi i qeverisë → funksionalizimi i plotë i institucioneve. Neni 65 përcakton kompetencat e Kuvendit, ndërsa Neni 95 përcakton procedurën kushtetuese për zgjedhjen e qeverisë. Pas konstituimit të Kuvendit, duhet të aktivizohet procedura për formimin e Qeverisë sipas rregullave të përcaktuara në Kushtetutë. Kushtetuta nuk e ka ndërtuar sistemin institucional në mënyrë që njëri institucion të mund ta mbajë peng të gjithë ciklin institucional për një kohë të pakufizuar. Pikërisht për këtë arsye, përgjegjësia e subjekteve parlamentare është që të mos e ndërpresin zinxhirin kushtetues të funksionalizimit të shtetit. Në një sistem parlamentar, zgjedhjet nuk përbëjnë pikën përfundimtare të procesit demokratik. Ato janë fillimi i një procesi të ri institucional që duhet të çojë në konstituimin e parlamentit dhe në formimin e qeverisë.

VII. Abuzimi me kompetencën kushtetuese dhe ometimi kushtetues

Këtu kemi një çështje më të ndërlidhur dhe më të ndjeshme të së drejtës kushtetuese. Një kompetencë kushtetuese nuk duhet parë vetëm si një privilegj i subjektit që e ushtron atë. Çdo kompetencë kushtetuese ekziston për të realizuar një funksion kushtetues dhe për t'i shërbyer funksionimit të institucionit dhe të shtetit. Nëse një subjekt politik ka mundësinë dhe përgjegjësinë për të ndërmarrë veprime që çojnë në funksionalizimin e institucioneve, por e përdor pozitën e tij për të shkaktuar ose për të zgjatur një bllokim institucional, atëherë lind pyetja nëse kemi të bëjmë thjesht me ushtrim të një kompetence politike apo nëse, në rrethana të caktuara, mund të shtrohet edhe çështja e keqpërdorimit të pozitës kushtetuese. Kjo kërkon një analizë shumë të kujdesshme dhe nuk mund të konkludohet vetëm mbi bazën e një vlerësimi politik. Në këtë kontekst mund të shtrohet edhe çështja e ometimit kushtetues. Ometimi kushtetues mund të shfaqet kur mosveprimi

i një organi publik krijon një boshllëk në realizimin e një detyrimi kushtetues dhe pengon funksionimin efektiv të rendit kushtetues. Megjithatë, ky koncept duhet përdorur me shumë kujdes. Ometimi kushtetues nuk mund të shpallet vetëm përmes një deklarate politike. Ai kërkon analizë juridike të detyrimit kushtetues, subjektit përgjegjës, natyrës së mosveprimit, kohëzgjatjes së tij dhe pasojave që prodhon. Pikërisht për këtë arsye, është e nevojshme që debati mbi ometimin kushtetues të mos shndërrohet në një etiketë politike, por të mbetet pjesë e një analize serioze juridiko-kushtetuese.

VIII. Gjykata Kushtetuese nuk mund të zëvendësojë marrëveshjen politike

Neni 112.1 e përcakton Gjykatën Kushtetuese si autoritetin përfundimtar për interpretimin e Kushtetutës. Ndërkohë, Neni 113 përcakton kompetencat e gjykatës dhe subjektet që mund t'i drejtohen asaj në rastet e përcaktuara nga Kushtetuta. Kjo është jashtëzakonisht e rëndësishme për situatën aktuale. Nëse subjektet e autorizuar konsiderojnë se një veprim ose mosveprim institucional ka prodhuar një problem kushtetues, rruga është institucionale: çështja duhet t'i paraqitet Gjykatës Kushtetuese sipas procedurës përkatëse. Por gjykata nuk mund ta zëvendësojë vullnetin politik të partive. Gjykata mund të interpretojë Kushtetutën, të përcaktojë kufijtë kushtetues të veprimeve institucionale dhe të konstatojë shkeljet kur plotësohen kushtet juridike. Ajo mund të japë një zgjidhje juridike brenda kompetencës së saj, por nuk mund të krijojë një marrëveshje politike aty ku subjektet politike refuzojnë ta bëjnë atë. Kjo ndarje ndërmjet juridikes dhe politikës është thelbësore për funksionimin e një shteti kushtetues.

IX. Jurisprudenca kushtetuese duhet të respektohet dhe nuk mund të relativizohet

Debati aktual duhet të zhvillohet mbi bazën e Kushtetutës dhe të jurisprudencës ekzistuese të Gjykatës Kushtetuese. Rasti KO119/14 është një pikë e rëndësishme reference për çështjen e zgjedhjes së Kryetarit të Kuvendit dhe funksionalizimit të tij. Po ashtu, praktika kushtetuese e Kosovës ka trajtuar çështje të afateve, formimit të institucioneve dhe pasojave të dështimit të proceseve kushtetuese. Kjo jurisprudence duhet të lexohet në mënyrë sistematike dhe në kontekstin konkret të secilit rast. Në këtë kontekst, duhet të përdorim me kujdes konceptin res judicata – çështje e gjykuar. Jo çdo situatë e re politike është automatikisht res judicata vetëm sepse i ngjan



një rasti të mëparshëm. Për të folur për çështje të gjykuar duhet të ekzistojnë kushtet juridike përkatëse dhe identiteti i nevojshëm i çështjes së gjykuar. Por një parim themelor nuk mund të relativizohet: vendimet e Gjykatës Kushtetuese duhet të respektohen dhe të zbatohen. Neni 116 i Kushtetutës përcakton efektin juridik të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Vendimet e saj nuk janë këshilla politike dhe as opinione fakultative. Ato janë pjesë e rendit kushtetues dhe kanë fuqi juridike detyruese. Në një shtet kushtetues, jurisprudenca kushtetuese nuk mund të përdoret në mënyrë selektive: nuk mund të pranohet kur i shërben një pozicioni politik dhe të refuzohet kur nuk i shërben atij.

X. Zgjidhja është përgjegjësia politike dhe marrëveshja për funksionalizimin e shtetit

Pas gjithë këtyre sqarimeve, përfundimi im është i qartë. Kosova nuk ka nevojë për një luftë të re interpretimesh kushtetuese. Kosova ka nevojë për përgjegjësi politike, maturi institucionale dhe vullnet për kompromis.


1. Duhet të konstituohet Kuvendi.
2. Duhet të zgjidhet kryetari dhe Kryesia e Kuvendit.
3. Duhet të fillojë dhe të përfundojë procedura kushtetuese për formimin e qeverisë.
4. Duhet të krijohen kushtet kushtetuese për zgjedhjen e presidentit të Republikës.
5. Dhe, mbi të gjitha, duhet të rikthehet funksionaliteti i plotë i institucioneve të Republikës së Kosovës.

Si njëri nga hartuesit kryesorë të Kushtetutës, dua ta them qartë: Kushtetuta nuk është shkruar për të bllokuar shtetin. Ajo është shkruar për ta bërë shtetin

funksional. Kushtetuta është kompromis politik i institucionalizuar. Ajo është marrëveshja themelore mbi rregullat e bashkëjetesës politike dhe institucionale. Prandaj, kur politika hyn në krizë, zgjidhja nuk mund të jetë keqpërdorimi i Kushtetutës. Zgjidhja duhet të jetë kthimi te Kushtetuta, te dialogu, te përgjegjësia dhe te kompromisi politik.

Apeli im është i drejtpërdrejtë për të gjitha subjektet politike parlamentare:

1. Mos e mbani shtetin peng të kalkulimeve partiake.
2. Mos e përdorni Kushtetutën si instrument bllokimi.
3. Mos e degradoni debatin kushtetues me interpretime të improvizuara.
4. Respektoni Kushtetutën dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese.
5. Arrini një marrëveshje politike gjithëpërfshirëse për funksionalizimin e institucioneve të Republikës.
6. Kosova ka kaluar nëpër sfida shumë më të mëdha se kjo. Ajo ka ndërtuar institucionet e saj mbi kompromis, përgjegjësi dhe vullnet shtetformues.
7. Sot, më shumë se kurrë, kërkohet pikërisht kjo përgjegjësi.
8. Çdo ditë e humbur në një bllokadë institucionale e dëmton autoritetin e shtetit, e dobëson besimin e qytetarëve dhe krijon një precedent të rrezikshëm për kulturën kushtetuese të Republikës.
9. Prandaj, thirrja ime është e drejtpërdrejtë: konstituoni Kuvendin, formoni qeverinë, zgjidhni presidentin, funksionalizoni shtetin.
10. Kushtetuta e Republikës së Kosovës është më e madhe se çdo parti politike dhe interesi i shtetit është më i madh se çdo kalkulum elektoral. Tani është koha që politika ta rikthejë kompromisin në funksion të Kushtetutës dhe Kushtetutën në funksion të Republikës së Kosovës, shtetit tonë sovran dhe të pavarur.



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Trumpi: Gabim i madh nëse largohet Infantino

WASHINGTON, 11 GUSHT - Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, ka dalë në mbështetje të presidentit të FIFA-s, Gianni Infantino, i cili po përballlet me presion të madh për shkak të planit të dështuar për lejimin e investimeve private në Kupën e Botës.

Trumpi ka thënë se FIFA nuk do të ishte "kurrë aq e suksesshme apo fitimprurëse" pa Infantinon. "FIFA do të bënte një gabim të tmerrshëm nëse, për çfarëdo arsye, do të mendonte ta zëvendësonte presidentin Gianni Infantino. Ai është fantastik dhe sapo ka drejtuar

Kupën e Botës më të suksesshme, katër herë më të suksesshme se çdo tjetër që është zhvilluar më parë", ka deklaruar Trumpi. Federatat e futbollit nga Evropa, Amerika e Veriut dhe Azia kanë kërkuar largimin e Infantinos, ndërsa kanë bërë thirrje edhe

për një rishikim të pavarur të propozimit të braktisur. Në një letër të përbashkët, federatat kanë deklaruar se Infantino ka dëmtuar besimin e tyre përmes "mashtimit" dhe se ka "vendosur veten mbi kolektivin". Pavarësisht prej presionit, Trumpi ka vendosur ta



mbështesë publikisht Infantinon, me të cilin ka pasur bashkëpunim të ngushtë gjatë Kupës së Botës 2026.

FFK-ja MBAN TAKIM ME DELEGATËT PARA EDICIONIT TË RI: MOBILIZIM MAKSIMAL PËR NJË KAMPIONAT TË SUKSESSHËM

PRISHTINË, 11 GUSHT - Në prag të fillimit të edicionit të ri garues 2026/2027, Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) ka mbajtur takimin e rregullt me delegatët e ndeshjeve të Albi Mall Superligës dhe Ligës së Parë. Takimi kishte për qëllim bashkërendimin e punëve, ngritjen e nivelit të organizimit dhe përgatitjen e zyrtarëve për sfidat e edicionit të ri. Presidenti i FFK-së, Agim Ademi, ka përgëzuar delegatët për punën e bërë deri më tani, ndërsa ka kërkuar mobilizim dhe përgjegjësi maksimale që nga java e parë e kampionatit. "Jemi në prag të një edicioni të ri garues që kërkon përkushtim absolut nga të gjithë ne. Delegatët janë



pasqyrë e profesionalizmit dhe e zbatimit të rregulloreve në fushë. Kërkoj nga secili prej jush mobilizim të plotë, vigjilencë dhe korrektësi

maksimale në çdo ndeshje, në mënyrë që kampionati të ketë mbarrëvajtje shembullore", ka deklaruar Ademi. Gjatë takimit delegati me

përvojë ndërkombëtare, Zgjim Sojeva, ka mbajtur një ligjëratë në të cilën ka ndarë përvojat nga ndeshjet ndërkombëtare, me fokus te menaxhimi i situatave komplekse gjatë zhvillimit të një ndeshjeje. Ndërkohë zyrtari për Integritet i FFK-së, Gazmend Bojniku, ka folur për integritetin e garave, mbrojtjen e lojës nga çdo ndikim negativ dhe rëndësinë e parandalimit të parregullsive. "Integriteti i garave është shtylla kryesore e besueshmërisë së futbollit tonë. Si zyrtarë të ndeshjeve ju keni rolin kyç në ruajtjen e pastërtisë së lojës dhe frymës së 'Fair Play'-it. FFK mbetet e pakompromis ndaj çdo dukurie negative dhe do të

garantojë barazi të plotë për të gjithë pjesëmarrësit", ka thënë Bojniku.

Në takim kanë marrë pjesë edhe kryetari i Komisionit të Garave, Abdyl Bellopoja, dhe administratori i Superligës dhe Ligës së Parë, Agron Shosholli. Ata kanë diskutuar me delegatët për ndryshimet në aktet normative të garave si dhe për çështje të tjera që lidhen me organizimin dhe mbarrëvajtjen e kampionatit të ri.

Pas ligjëratave dhe diskutimeve, delegatët i janë nënshtruar edhe testit të përgatitur për këtë qëllim. Edicioni i ri i garave në Superligë hapet të premtën me ndeshjen ndërmjet Feronikelit 74 dhe Gjilanit.

BERAT GJIMSHITI LARGOHET NGA ATALANTA, TRANSFEROHET NË ARABINË SAUDITE

RIAD, 11 GUSHT - Berat Gjimshiti i ka dhënë fund aventurës në Serinë A pas transferimit zyrtar nga Atalanta tek Al Diriyah në Arabinë Saudite. Kapiteni i Kombëtares së Shqipërisë është transferuar për shumën prej 3 milionë eurosh, duke nisur kështu një kapitull të ri në karrierën në futbollin saudit. Gjimshiti ka qenë pjesë e Atalantës prej vitesh, ndërsa gjatë qëndrimit në Bergamo është shndërruar në një nga




figurat më të rëndësishme të skuadrës, duke mbajtur edhe shiritin e kapitenit. Pas zyrtarizimit të largimit, mbrojtësi shqiptar ka ndarë një mesazh emocionues për klubin

dhe qytetin e Bergamos. "Mbërrita i ri në Bergamo, largohem me shumë krenari dhe me një shtëpi të dytë e familje. Faleminderit Atalanta dhe qyteti i Bergamos!", është shprehur Gjimshiti.

31-vjeçari do ta vazhdojë karrierën në Arabinë Saudite, ku do të jetë pjesë e Al Diriyah dhe do të përballlet me një sfidë të re pas një periudhe të gjatë e të suksesshme në futbollin italian.

KORENICA KËRKON LARGIMIN NGA CLUJI

BUKURESHT, 11 GUSHT - Meriton Korenica është duke kërkuar të largohet nga skuadra rumune Cluj. Korenica po e kërkon largimin edhe për shkak të problemeve financiare me të cilat po përballlet Cluji kohët e fundit. Reprezentuesi i Kosovës dëshiron të luajë për një ekip tjetër. Mësohet se tashmë ka disa oferta për sulmuesin e krahut, shkruan "Spotmedia". Skuadra si Universitatea Craiova dhe Rapid Bukuresht kanë shprehur interesim për Korenicën. 29-vjeçari është një prej futbollistëve më të



rëndësishëm të Clujit, ekip me të cilin ka kontratë deri në verën e vitit të ardhshëm.

Kane fiton "Këpucën e Artë" të Evropës

Bayern, 11 gusht - Harry Kane zyrtarisht e ka fituar "Këpucën e Artë" të Evropës për sezonin 2025/26, pasi ka qenë golashënuesi më i mirë në kampionatet evropiane. Për sulmuesin anglez, kjo është

hera e dytë në karrierë që shpallet golashënuesi më i mirë, pasi këtë çmim e ka fituar edhe për sezonin 2023/24. Kane sezonin e shkuar ka realizuar 36 gola në Bundesligë, duke e udhëhequr Bayernin

drejt titullit të kampionit. Vetëm Lionel Messi dhe Cristiano Ronaldo e kanë fituar këtë çmim më shumë herë se Kane, të cilit trofeu do t'i dorëzohet më 19 gusht në ceremoninë zyrtare që do të

mbahet në muzeun e Bayern Munichut.

Kane, 33-vjeçar, është një prej sulmuesve më produktivë në Evropë, ndërsa pritet që së shpejti ta rinovojë kontratën me skuadrën gjermane.



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Mix Shop Jara” Sh.P.K. me seli në Vushtrri, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 812343309 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Mix Shop Jara” D.O.O. od Vushtrria, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812343309 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “FLEMINGO KOSOVO” L.L.C. with headquarters Vushtrri, has come to the decision to quit its business: 812343309 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Power Your German” Sh.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 812360767 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Power Your German” D.O.O. od Prishtina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812360767 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Power Your German” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 812360767 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT**SWISS****TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Bardh Kupa shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Mirjeta Kryeziu shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lush Biblekaj B.I. shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues: 811140772 të lëshuar nga ARBK.

- Valmir Karavidaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti” në Mazdrek.

- Elton Halili shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së 11 të shkollës së mesme të lartë të mjekësisë “Dr. Xheladin Deda”.

- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.

- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m.”Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjmnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjmnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1908

RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1908

MEKA
®
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

